



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



**Kuvendi i Komunës Istog**  
Skupština Opštine Istok  
Municipal Assembly Istog

Komititeti për Politikë dhe Financa / Komitet za Politiku i Financije / Policy and Finance Committee

Nr. 38	P r o c e s v e r b a l
<b>Tipi i mbledhjes:</b>	Mbledhje e Rregullt e KPF-së
<b>Data e mbajtjes:</b>	22.04.2025 në ora 10:00
<b>Mbledhjen e kryesoi:</b>	Enver Rugova, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Istogut
<b>Procesmbajtës:</b>	Flora Bujupaj Asistente Administrative pranë Zyrës së Kryesuesit të Kuvendit
<b>Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së</b>	Hajrush Shoshi, Liridona Lajçi, Faruk Kabashi, Ardit Idriza dhe Arian Shatri.
<b>Mungojnë:</b>	
<b>Pjesëmarrës të tjera:</b>	Nënkyrtetari i Komunës Ali Nimanaj, Drejtorët: Genc Ademaj, Abedin Kabashi, Arben Kabashi, Merita Bytyçi, Vlora Vuthaj, Zenel Shatri, Naim Behlulaj, zyrtar administrativ: Ardon Arifaj

#### Rendi i ditës:

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
- Shqyrtimi i raportit finansiar për tre muajin e parë (Janar - Mars) të vitit 2025,
- Shpallja në diskutim publik e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin Vendeve të Punës në Administratën Komunale.

#### Diskutimet:

**Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova** - përshëndeti të pranishmit.

Konstaton se të pranishëm janë 6 anëtarë të KPF-së prezent, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e mbledhjes. Hapi punimet për këtë mbledhje me këtë rend dite.

Prezanton rendin e ditës,

Fton ekzekutivin si dhe anëtarët e KPF-së nëse dikush ka ndonjë pyetje sugjerim apo ndonjë propozim pë rend dite?

**Kryesuesi i Kuvendit** - përshëndet të gjithë! Një pikë shtesë për rendin e ditës së sotme, është Shqyrtimi dh miratimi i Rregullores për Transparencë Komunale të hyj në rend dite për mbledhjen e sotme, kjo pik propozohet tani sepse ditën kur është dërguar Rregullorja ende ka qenë në Dëgjim Publik kështu që n pamundësi ta futim atë ditë në rend dite, po e propozoj sot. Kush është që kjo pikë të hyn në rend dite?

**Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë të hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** pyes ekzekutivin a ka ndonjë propozim apo diçka tjetër rrëth rendit të ditës? Drejtori Genc Ademaj e ka fjalën.

**Genc Ademaj-** pika që propozoj që të hyn në rend dite Bartja e mjeteve të pa shpenzuara buxhetore t'hyrave të bartura nga viti fiskal 2024 dhe të hyrat e tejkaluara në vitin 2025. Gjithashtu po e shfrytëzoj rasti që ti propozoj edhe disa pika tjera, Shpallja në diskutim publik e Rregullores për Subvencione, dhe Shpallja n diskutim publik e Rregullores për Tregun tërë ditor në Istog.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka drejtori Agon Dreshaj.

**Agon Dreshaj-** propozon një pikë për rendin e ditës së sotme, e kemi një kërkesë të banorit të fshatit Rakos z. Izet Haxhijaj i cili bashkë me pronarët e lagjës e kanë të bashkëngjitur në kërkesë edhe 26 nënshkrime pë për destinimin e lokacionit për varreza në fshatin Rakosh. Për mbledhje të Kuvendit do e keni materialin gatshëm.

**Kryesuesi i Kuvendit-** a ka edhe dikush diçka? Pasi që jo po votojmë.

Kush është të hyj në rend dite pika e parë e propozuar nga drejtori Genc Ademaj, Bartja e mjeteve të p shpenzuara buxhetore t'hyrave të bartura nga viti fiskal 2024 dhe të hyrat e tejkaluara në vitin 2025?

**Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë të hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.**

Kush është të hyj në rend dite pika e dytë e propozuar nga drejtori Genc Ademaj, Shpallja në diskutir publik e Rregullores për Subvencione?

**Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë të hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.**

Kush është të hyj në rend dite pika e tretë e propozuar nga drejtori Genc Ademaj, Shpallja në diskutir publik e Rregullores për Tregun tërë ditor në Istog?

**Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë të hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.**

Kush është të hyj në rend dite pika e tjetër e propozuar nga drejtori Agon Dreshaj, për destinimin lokacionit për varreza në fshatin Rakosh me kërkesë të banorëve të fshatit?

**Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë të hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** hedh në votim rendin e ditës në tërësi me propozimet e dhëna? Kush është t miratohet rendi i ditës për ditën e sotme?

**Unanim Miratohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme.**

**Prezent në mbledhje janë 6 anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

**Vendimet:**

**Miratohet unanim rendi i ditës për mbledhjen e sotme.**

**Personat përgjegjës për zbatim:**

Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:**

Deri në mbledhjen e kuvendit

### **Shqyrtimi i pikës 1.**

**Diskutimet:**

**Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova**, vazhdojmë më pikën e parë të rendit të ditës' Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A ka dikush diçka rrëth procesverbalit?

Pasi që nuk ka diskutime.

Hedh në votim, kush është që të miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar?

**Miratohet unanim procesverbali nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.**

**Vendimet:**

**Personat përgjegjës për zbatim:**

Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:**

Deri në mbledhjen e kuvendit

### **Shqyrtimi i pikës 2.**

**Diskutimet:**

**Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova** - vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës. Shqyrtimi i raporti financiar për tre mujorin e parë (Janar -Mars) të vitit 2025. Fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

**Genc Ademaj-** prezanton Raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar -Mars) të vitit 2025.

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin rrëth kësaj pike. A e dëshiron dikush fjalën? Pasi që jo, hedh në votir pikën e rendit të ditës?

**Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë t'i kaloj Kuvendit të Komunës për shqyrtim.**

**Gjashtë anëtarë prezent në mbledhje.**

**Vendimet:**

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF - ja unanim ia kalon kuvendit të komunës për shqyrtim Raportin financiar për tre mujorin e parë (Janar -Mars) të vitit 2025.

**Personat përgjegjës për zbatim:**

Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:**

Deri në mbledhjen e kuvendit

### **Shqyrtimi i pikës 3.**

**Diskutimet:**

**Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova**, vazhdojmë me pikën e tretë. Shpallja në diskutim publik Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratë Komunale. E hapi diskutim, materialin e keni marrë, është një pikë e ndjeshme. Fjalën e ka drejtori Gen Ademaj.

**Genc Ademaj-** nëse e shikojmë Statutin e Komunës për dallim prej komunave të tjera, e di që është bërë një kërkësë për interpretim te MAPL-ja nëse nuk gaboj, unë mendoj që pjesa e Sistematizimit nuk i takohet shpalljes në Diskutim Publik, sepse ky diskutim publik nuk ka të bëj vetem mes nesh por edhe me qytetarë

Nuk e di se cili është vendimi apo sugjerimi i qytetarëve në këtë Rregullore. Ne e kemi pasur më herët një Rregullore ose realisht i kemi miratuar disa Rregullore ne bashkëpunim me USAID-n bazuar në Statutin Komunës është drejtë ekskluzive e miratimin e vetëm nga ana e Kryetarit dhe nuk kërkon procedura të tjera. Unë vetëm po e kam frikën që MAPL-ja na jep interpretim bazuar në Statutet e komunave të tjera që realish secila komunë e ka Statutin e vet. E di që edhe DMZP-ja e ka dhënë një kërkësë, por nëse është akt i miratua prej organeve dhe e ka një bazë ligjore pse duhet me dalë në Diskutim Publik. Nuk e di sa mundet me nqjallë probleme duke marrë parasysh ambiciet e gjithësecilit zyrtarë që pretendon rrogën më të lartë, ku është zhvilluar një procedurë e rekrutimit është zhvilluar mbi bazën e detyrave dhe përgjegjësive dhundësinë buxhetore dhe kualifikimin e kërkuar. Pastaj kjo mundet me e humb kuptimin. E kam rastin t zyrtari kryesor finansiar, është specialist i financave dhe e ka pagën e një zyrtari të lartë. Nëse ne e barazojm me përgjegjësi, përgjegjësia është më e madhe se çdo inxhinieri apo specialisti në nivel të komunës. Ajo çk po dua të them është se nese e shpallim në diskutim publik vjen ZKF-ja ankohet me këtë sistematizim cil është zgjidhja jonë? Se duhet me ja bërë një zgjidhje atij me nivelin e përgjegjësisë që e ka. Për atë e thashë q sistematizimi duhet me qenë pjesë e brendshme e jo pjesë e dëgjimit publik. Nuk e di sa është trajtuar mir me MAPL-në dhe DMPZ-në. Këto i pata unë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** kjo vërtetë është sfiduese, kur është Rregullore ajo në fakt duhet të dalë në Kuvenc Po kjo lloj Rregulloreje siç e tha drejtori bëhet nëpërmjet kontrateve që bëhen me punëtorë dhe katalogut t vendeve të punës. Ne po e dërgojmë deri në Kuvend, ndërkohë nëse MAPL-ja na thotë që nuk keni nevojë h heqim prej rendit të ditës.

**Genc Ademaj-** MAPL-ja patjetër që ka me na thënë po. Se ata i nënshtrohen një procedure të përgjithshm bazuar në krejt komunat tjera. Nuk e di a e ka edhe ndonjë komunë tjetër në Statut siç e kemi ne përparësin që kryetari ka të drejta shtesë. Për atë po them nëse mundemi ta mbrojmë ligjërisht ta dërgojmë deri në fund

**Kryesuesi i Kuvendit-** kemi me u përpjekur drejtor. A ka edhe dikush diçka ? Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- unë besoj që çdo formimi apo përpilimi të një Rregullore i paraprinë një vendim i kryetari për formimin e komisionit. Këto çka i tha drejtori, ose është dashur ekzekutivi ta tërheq ose të vazhdoj m procedura. Nuk është kompetencë e jona me vendos. Nëse është formuar një komision për hartimin e kësaj Rregullore atëherë vendimi është i kryetarit. Nëse është ndryshe është i gabuar, ne nuk kemi asnj kompetencë as me heq, ekzekutivi është ai që duhet ta tërheq.

**Genc Ademaj-** te Rregullorja patjetër që e don procedurën e KPF-së, Kuvendit dhe Dëgjimit Publik. Po çështja është te sistematizimi.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Nënkyetari i Komunës.

**Nënkyetari i Komunës-** jep sqarim shtesë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** jemi pak në akt të kryer, po e dërgojmë për Kuvend, ndërkohë nëse komunikojmë m MAPL-në dhe DMZP-në kërkojmë interpretim ligjor, nëse thonë me e qit, ja bëjmë ashtu. Po procedojmë, e t shohim se çfarë po ndodhë.

**Genc Ademaj-** jep sqarime shtesë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hedh në votim, kush është të shkoj për Kuvend?

Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë t'i kaloj Kuvendit të Komunës për shqyrtim dh miratim.

**Gjashtë anëtarë prezent në sallë.**

**Vendimet:**

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës pikën rendit të ditës 'Shpallja në diskutim publik e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dh Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale.

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendit

#### **Shqyrtimi i pikës 4.**

**Diskutimet:**

**Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova,** - po vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës. Shqyrtimi dh miratimi i Rregullores për Transparencë Komunale. A ka dikush diçka? Pasi që nuk ka dikush diçka. E hedh në votim:

Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë t'i kaloj Kuvendit të Komunës për shqyrtim dh miratim.

**Gjashtë anëtarë prezent në sallë.**

**Vendimet:**

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës pë shqyrtim dhe miratim 'Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Transparencë Komunale.

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendit

#### **Shqyrtimi i pikës 5.**

**Diskutimet:**

**Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova,** - po vazhdojmë më pikën e pestë të rendit të ditës. Bartja e mjeteve t pa shpenzuara buxhetore të hyrave të bartura nga viti fiskal 2024 dhe të hyrat e tejkaluara në vitin 2025. Fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

**Genc Ademaj-** prezanton pikën e rendit të ditës 'Bartja e mjeteve t pa shpenzuara buxhetore të hyrave t bartura nga viti fiskal 2024 dhe të hyrat e tejkaluara në vitin 2025.

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hap debatin për këtë pikë të rendit të ditës?

**Hajrush Shoshi-** çështje e trotuarit Banjë-Saradran ishin diku 50.000 euro të ndara. A janë komplet sa janë t parapara në kontratë se projekti ka qenë dy vjeçar.

**Genc Ademaj-** është e shkurtuar për 60.000 euro, e kemi lënë te pjesa e bartjes së dytë, tanjemi në fazën kontraktimit të projekteve që i kanë dy burime të financimit, operatori është i obliguar që gjatë vitit t realizoj kontratën në fjalë. Por ta kemi parasysh që gjatë muajit Qershor do ta kemi edhe një bartje, për shka

të tepricës.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush diçka? E hedh në votim

Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë t'i kaloj Kuvendit të Komunës për shqyrtim dh miratim.

Gjashtë anëtarë prezent në sallë.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim 'Bartja e mjeteve të pa shpenzuara buxhetore të hyrave të bartura nga viti fiska 2024 dhe të hyrat e tejkaluara në vitin 2025.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

### Shqyrtimi i pikës 6.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë më pikën e gjashtë të rendit të ditës. Shpallja n diskutim publik e Rregullores për Subvencione, kush është që kjo pikë t'i procedohet në mbledhjen Kuvendit?

Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë t'i kaloj Kuvendit të Komunës për shqyrtim dh miratim.

Gjashtë anëtarë prezent në sallë.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim 'Shpallja në diskutim publik e Rregullores për Subvencione.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

### Shqyrtimi i pikës 7.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë më pikën e shtatë të rendit të ditës. Shpallja n diskutim publik e Rregullores për Tregun tërë ditor në Istog. Kush është që kjo pikë t'i procedohet në mbledhjen e Kuvendit?

Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë t'i kaloj Kuvendit të Komunës për shqyrtim dh miratim.

Gjashtë anëtarë prezent në sallë.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim 'Shpallja në diskutim publik e Rregullores për Tregun tërë ditor në Istog.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

## Shqyrtimi i pikës 8.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë më pikën e tetë të rendit të ditës. E hap debatin për këtë pikë të rendit të ditës? Pasi nuk ka diçka e hedh në votim.

Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë t'i kaloj Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhmiratim.

Gjashtë anëtarë prezent në sallë.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim 'Destinimin e lokacionit për varreza në fshatin Rakosh.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoj : 11: 00.

Procesmbajtëse,  
Znj. Flora Bujupaj

Kryesuesi i Kuvendit,  
z. Enver Rugova

